



REPUBLIKA E KOSOVËS
Drejtoria e Inspektionit
Glllogoc, më 04.10.2018



RAPORT PËR MUAJIN SHTATOR 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar kontrolla në Institucionet Arsimore për kushtet tekniko-higjenike, kontrollë e transportit publik dhe ndërtimeve pa leje, ku me qëllim të mbikëqyrjes së vazhdueshme sidomos në lëminë e ndërtimit, është kujdestaruar edhe gjatë vikendit.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektorët e Ndërtimit gjatë këtij muaji kanë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veqanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale. Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar edhe aktvendime për pezullim të punimeve, kufizime me shenja zyrtare, aktvendime për rrënimë. Është përcjellur hapja e kanalit kullues në Korroticë të Epërme përmes kompanisë kontraktuese, e cila ka zhvilluar punime për disa ditë me radhë dhe ka mbetur edhe një pjesë pa u përfunduar për shkak të problemeve teknike dhe financiare të kompanisë.

Inspektori i Komunikacionit ka vazhduar me kontrolla të transportit rrugor dhe largimin e transportuesve ilegal, e gjithashtu kontrolla të rendit të udhëtimit të kompanive transportuese të licencuara. Gjatë këtij muaji është vazhduar me masat e radhës gjatë hasjes në transportues ilegal ku janë shqiptuar 7 gjoba mandatore në vlerë prej 100 euro si dhe 2 gjoba në vlerë prej 75 euro për kompanitë transportuese të licencuara të cilat kanë bërë shkelje të Ligjit gjatë transportit.

Inspektori Sanitar: gjatë këtij muaji ka bërë kontrollë të përgjithshme në të gjitha Institucionet Arsimore në Komunën e Drenasit. Në përgjithsi është konstatuar një gjendje e mirë higjenike, ku shifet se në shumicën prej shkollave janë bërë përgaditjet e duhura higjenike (gëlqerosja e shkollës përbrenda, dezinfektimet e përgjithshme të hapsirave). Janë disa prej shkollave që kanë probleme tekniko-sanitare dhe kanë nevojë për përmirësime, të cilat janë evidentuar me raport të përgjithshëm dhe janë përcjellë edhe në Drejtorinë Komunale të Arsimit. Në përgjithsi shkollat kanë furnizim me ujë të pijes dhe shumica prej tyre kanë hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave.

Inspektori i Tregut: me rëndësi të veçantë ka bërë largimin e tregtarëve që shesin jashtë lokacionit të tregut në rr. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci në ditën e tregut, gjithashtu janë inspektuar bizneset e reja të pa regjistruara, duke obliguar për tu pajisë me dokumentacionin e nevojshëm për biznes. Ka pasur një kërkesë për pëlqim në ushtrimin e veprimtarisë e cila është refuzuar për mungesë të dokumentacionit.

Inspektori i Ambientit ka vazhduar me kontrollën e bizneseve dhe urdhëresë për të hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave, gjithashtu ka shqyrtuar 15 kërkesa rreth ambientit dhe ka shqiptuar dy gjoba mandatore për shkelësit e Ligjit.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin shtator 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Gjoha mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Konfiskim i targave dhe automjeteve
I.sanitar	35	1		1	1			
I.Tregut	8					1		
I.komunikacionit	23		9					1 A
I.Ndërtimit	15	2				5	5	
I.Ambientit	20		2			15	15	
Totali	101	3	11	1	1	21	20	1

Tetor 2018